



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më _____. 2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

RIKONSTRUKSION I PJESSHËM I SALLËS SË AKTIVITETEVE TË QENDRËS
KULTURORE “MYRTEZA LEKA” DELVINË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi 45210000 – 2

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 16.666.666,67 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë, pa TVSH.**

- Ky objekt financohet nga Bashkia Delvinë (Investime nga Granti, Transferta e Pakushtëzuar) dhe (Granti i Bazuar në Performancë me financim të huaj), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 28 datë 31.07.2026 “Për disa shtesa dhe rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2026, shprehur ligjshmëria nga prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 1028/1 Prot, datë 12.08.2026”
- **Financimi për Vitin 2026 do të jetë 8.844.000 (tetë milionë e tetëqindë e dyzetë e katër mijë) Lekë me TVSH.**
 - **Financimi për Vitin 2027 do të jetë 11.156.000 (njëmbëdhjetë milionë e njëqindë e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë me TVSH.**

Argumentimi: Përlogaritja e vlerës limit të kontratës për këtë procedurë prokurimi është bërë duke iu referuar përcaktimeve të nenit 76 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë (Njësia e Prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona

të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vendosur të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 datë 23.09.2024 të miratuar nga APP.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Kriteri (1-a) është vendosur në bazë të neneve 76, 77 dhe 82 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 82 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe pikën 1 të nenit 30 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas (Shtojcës 7)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e Operatorit Ekonomik sipas “Shtojcës 8”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2023, 2024 dhe 2025), ku vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe në proporcion me vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP-së parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Në nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiarë.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Sa më sipër, duke qenë se lloji i procedurës është "E Hapur", është kërkuar që vlera minimale e xhiros vjetore për tu përmbushuar nga operatorët ekonomikë të jetë sa vlera e përlllogaritur e kontratës.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; si dhe Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit

dhe pasivit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.**

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 si dhe kështet e maturuara të vitit 2026, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE), çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së

(Kriteri 2.2.3 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632, datë

30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme, të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a)** Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë punimesh;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera
- b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat të shoqëruar me:
 - Kontratë punimesh;

- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera;
- Faturë tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me preventivin e ndarjes së punimeve që ka marrë përsipër të kryejë secili operator ekonomik në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, indryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht. Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1- a,b si dhe 1.1-1.2), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të

vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”. AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1- a,b si dhe 1.1-1.2, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standartit. AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, **i ndryshuar**. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Kategori	Kl.	Emërtimi i kategorisë
NP-1	A	Punime gërmimi në tokë
NP-2	A	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
NP-5	A	Punime nëntokësore
NP-7	A	Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje
NP-11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
NP-12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre
NS-3	A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
NS-4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
NS-8	A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
NS-13	A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
NS-14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
NS-18	A	Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi dhe/ose ekuivalentimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të zbatimit të punimeve, në përputhje me Detyrën e Projektimit, natyrën e objektit dhe praktikën të ngjashme të ndërtimit të godinave. Objekti i kontratës përfshin realizimin e një ndërrjeje me funksione komplekse ndërtimore dhe teknike, duke përfshirë punime strukturore në beton të armuar, punime gërmimi dhe themele, fasada, sisteme të jashtme, si dhe instalime të ndryshme elektrike, mekanike, hidrosanitare, sisteme sigurie, mbrojtje nga zjarri dhe sisteme të tjera inxhinierike të integruara. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi. NP-1 A Punime gërmimi në tokë: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimeve të gërmimit, sistemit të terrenit dhe përgatitjes së sheshit të ndërtimit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-1 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses; NP-2 A Ndërtime civile dhe Industriale: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila mund të përfshijë punimeve për forcimin/ realizimin e strukturës kryesore të godinës, përfshirë elementët mbajtës në beton të armuar, muret, kolonat, trarët dhe të gjitha punimet kryesore ndërtimore të objektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-2 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.; NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila parashikon punime për rikonstruksion të strukturës kryesore të godinës, përfshirë elementët fasada etj, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-3 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.; NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila parashikon punime për rikonstruksion të strukturës kryesore të godinës, përfshirë elementët fasada etj, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-3 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.; NP-5 A Punime nëntokësore.: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime rikonstruksioni terersor ose pjesor mund të nevojiten kryerja e punimeve nëntokësore qëllim I këtij projekti , është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-5 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses; NP-7 A Ujesjelles, kanalizime.: Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimeve për realizimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, si dhe sistemet e drenazhimit dhe kullimit të territorit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-7 A , me qëllim

përmbushjen e kontratës me sukses.; NP-11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punime të lidhura me furnizimin energjetik të objektit dhe infrastrukturën elektrike të jashtme, përfshirë lidhjet me rrjetin dhe strukturat teknike përkatëse, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.P-11 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.;NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me Rikonstruksion , sistemimet e jashtme, rehabilitimin e territorit, gjelbërimin, dhe ndërhyrjet që ndikojnë në përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit rrethues të objektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.P-12 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-1 A – Punime për prishjen e ndërtesave:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me prishje, pastrime strukturore ose heqje elementësh ekzistues në zonën e ndërtimit, si pjesë e përgatitjes së kantierit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-1 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-2 A – Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajta e tyre:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me instalimet e furnizimit me ujë, sistemet e kanalizimeve të brendshme, pajisjet sanitare dhe infrastrukturën hidraulike të godinës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-2 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-3 A – Impiante ngritese transportuese:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila mund të përfshin punimet që lidhen me instalimin e ashensorëve dhe sistemeve të transportit vertikal brenda objektit, në funksion të lëvizshmërisë dhe aksesueshmërisë së ndërtesës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-3 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-4 A – Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndertuese:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me punimet e rifiniturës së brendshme dhe të jashtme, përfshirë suvatime, lysterje, veshje, fasada, materiale druri, metali dhe plastike, si dhe elementë të tjerë përfundimtarë të objektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-4 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.NS-8 A – Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me elementë strukturore të veçantë të objektit, përfshirë ndërhyrje teknike specifike në fasade dhe elementë të veçantë inxhinierikë, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-8 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-13 A – Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni:Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me sistemet telefonike komunikacionit në institucion të cilat janë thelbësore për funksionimin normal dhe komfortin e godinës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-13 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-14 A – Impiante të brendshme elektrike dhe telefonike, radiotelefoni TV: Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me instalimet elektrike të brendshme, ndriçimin, sistemet e emergjencës, rrjetet e komunikimit, telefonisë dhe sinjalizimit në objekt, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.S-14 A , me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.; NS-18 A – Punime topogjeodezike”Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila përfshin punimet që lidhen me realizimin e rëlevimeve topografike, matjeve gjeodezike dhe kontrollit të kuotave gjatë gjithë

fazës së zbatimit të punimeve, duke garantuar saktësinë teknike të projektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.S-18 A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.;

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi ose kontrate noteriale me një shoqëri projektuese të licensuar sipas VKM-së Nr. 561, datë 15.7.2026 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.”

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

Kat.	1	c	Plane të detajuara vendore.
Kat.	2	a	Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale - turistike - vepra arti në infrastrukturë.
		b	Projektim: 2. Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.
		d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.
Kat.	3	a	Projektim objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
		b	Projektim: 2. objekte me skelet metalik.
Kat.	4	a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
		c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
		d	Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.
		h	Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)
		i	Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.
		f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
Kat.	8	a	Rilevime inxhinierike.
		b	Rilevime inxhinierike kadastrale.

		d	Bazamente gjeodezike.
Kat.	10	c	Projektim impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era, etj.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi dhe/ose ekuivalentimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-në Nr. 561, datë 15.7.2026 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të projektimit bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe disiplinat teknike të parashikuara në Detyrën e Projektimit. Nga analiza e Detyres së Projektimit rezulton se objekti përfshin projektimin e elementëve arkitektonikë, konstruktivë, hidroteknikë, elektrikë, mekanikë dhe të sistemeve të jashtme, si dhe projektimin e sistemeve të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit, ashensorëve dhe infrastrukturës ndihmëse.

Mbështetur në VKM Nr. 561, datë 15.7.2026 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim...” ku janë përcaktuar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim, AK ka kërkuar licencat profesionale të projektimit, kategori të lidhura drejtpërdrejt me disiplinat e projektimit që do të realizohen në kuadër të kontratës si me poshte: Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon në listpagesa për periudhën Qershor-Gusht 2026, staf teknik, të pajisur me licencë individuale në projektim, të aftë për kryerjen e shërbimit të projektimit sipas objektit të kësaj kontrate, si më poshtë:

Minimumi 1 (një) Arkitekt/Urbanist

Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturë)/Hidroteknik

Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik

Minimumi 1 (një) Inxhinier Topograf

Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik

Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektronik

Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë universitare sipas profilit, dhe CV. (Drejtesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si pjesë të kapaciteteve profesionale stafin kryesor projektues, duke u bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e objektit që do të projektohet dhe zbatohet. Objekti përfshin rikonstruksimin/projektimin e një godine me funksione të plota ndërtimore dhe inxhinierike, duke përfshirë strukturat mbajtëse, instalimet mekanike dhe elektrike, rrjetet hidraulike, sistemet e jashtme, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit, si dhe elementë të tjerë të specializuar teknikë. Për realizimin me sukses të objektit të kontratës AK vlerëson që operatori ekonomik duhet të disponojë një grup ekspertësh të kualifikuar që mbulojnë të gjitha disiplinat e projektimit.; Referuar Detyres së Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e Projektuesit Arkitekt për projektimin e zgjidhjeve arkitektonike të objektit, organizimin funksional të ambienteve, trajtimin e fasadave, materialeve të ndërtimit, aksesueshmërisë dhe integrimin e objektit me mjedisin përreth.; Referuar Detyres së Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e Projektues Konstruktör për projektimin e themeleve, strukturës së betonarmuar, elementëve mbajtës dhe verifikimin e qëndrueshmërisë strukturore të objektit në përputhje me normat teknike në fuqi.; Referuar Detyres së Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e Projektues Instalator për projektimin e instalimeve mekanike dhe elektrike, sistemeve të ventilimit dhe kondicionimit, instalimeve të mbrojtjes nga zjarri, sistemeve të sigurisë, ndriçimit, energjisë elektrike dhe sistemeve të emergjencës.; Referuar Detyres së Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e Projektues Gjeodet për realizimin e rëlevimeve topografike, përcaktimin e koordinatave, kuotave, kufijve të ndërhyrjes dhe përgatitjen e bazës topografike mbi të cilën do të mbështetet projektimi.; Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkitë e këtyre specialistëve është e domosdoshme dhe proporcional me objektin e kontratës, pasi secili prej tyre mbulon një disiplinë specifike të*

projektimit që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë, funksionalitetin dhe përputhshmërinë ligjore të projektit që do të hartohet dhe zbatohet.

2.3.5 Personelin kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Arkitekt/Urbanist

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktura)/Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Topograf

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Elektronik

1 (një) Inxhinier Mjedisi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë universitare sipas profilit, dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të Detyres së Projektimit si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Detyren e Projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Referuar Detyres së projektimit, kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë është e nevojshme prezenca e stafit të kualifikuar perkatesisht: Arkitekt, Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktura)/Hidroteknik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Topograf, Inxhinier Elektrik,, Inxhinier Elektronik, Inxhinier Mjedisi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf ose kontratë noteriale bashëpunimi me një shoqëri projektuese/individ të licencuar, të licencuar sipas VKM-së Nr. 561, datë 15.7.2026 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.”

- Eksperti i licencuar: “Për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 64, datë 12.05.2022 “Për kriteret e veçanta të dhënies së certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin MZSH”, (I ndryshuar)
- Ekspert i licencuar si Auditues i Energjisë në Ndërtesa “Për hartimin e Raportit paraprak të efikasitetit energjetik në ndërtesa”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të projektimit bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe disiplinat teknike të parashikuara në Detyrën e Projektimit. Nga analiza e Detyrës së Projektimit rezulton se objekti përfshin projektimin e MNZ si dhe Raport të efikasitetit të ndërtesave në përputhje me ligjin 107/2014 “Për Urbanizimin”, AK ka kërkuar licencat profesionale të projektimit, kategori të lidhura drejtpërdrejt me disiplinat e projektimit që do të realizohen në kuadër të kontratës si me poshte: Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi / Hidroteknik

1 (një) Arkitekt / Urbanist

1 (një) Inxhinier Topograf

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë universitare sipas profilit, dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të Detyrës së Projektimit si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Detyrën e Projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës, të

cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Referuar Detyres se projektimit, kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë është e nevojshme prezencë e stafit të kualifikuar mbështetës perkatesisht: Arkitekt, Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktural)/Hidroteknik, Inxhinier Topograf.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 28 (njëzetë e tetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën Qershor-Gusht 2026, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e kërkuar Qershor-Gusht 2026
- b)** Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar Qershor-Gusht 2026.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Detyres se Projektimit (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Autoriteti Kontraktor argumenton se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 28 punonjësish është vendosur në përputhje me natyrën, punimet që do të realizohen, vlerën e kontratës që do të prokurohet si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm. Referuar natyrës së objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për një staf teknik prej minimalisht 28 punëtorësh është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Ky staf përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar, organizimin efektiv të punës në kantier në disa fronte njëkohësisht, vijimësinë e punimeve pa ndërprerje, respektimin e standardeve teknike dhe të sigurisë në punë dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të të gjitha zërave të punimeve të parashikuara.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërbërje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të stafit teknik

te nevojshmem per realizimin e objektit te kontrates si dhe bazuar ne kontrata te ngjashme me tipologji te njeje me objektin e prokurimit. Gjithashtu per te vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

Teknik ndërtimi - Minimumi **1** (një) punonjës

Hidraulik – Minimumi **2** (dy) punonjës

Elektriçist – Minimumi **1** (një) punonjës

Saldator i certifikuar me SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent – Minimumi **2** (dy) punonjës

Axhustator i certifikuar me SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent – Minimumi **1** (një) punonjës

Montator – Minimumi **1** (një) punonjës

1 (një) punonjës i certifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent;

Operatori ekonomik ofertues punonjësin e certifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO9712-2022 ose ekuivalent, mund ta ketë pjesë të stafit ose me kontratë bashkëpunimi.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Për punonjësit e punësuar në stafin e tij, minimalisht për periudhën Qershor - Gusht 2026, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune të vlefshme; Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën minimalisht për periudhën Qershor - Gusht 2026; Certifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj. Për punonjësin e certifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent, nëse nuk rezulton në listëpagesat e shoqërisë, duhet të paraqesë Kontratë noteriale bashkëpunimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata

objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Detyres se Projektimit (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me detyren e projektimit, licencat profesionale të kerkuara sipas pikes 2.3.4 duke marrë në konsideratë natyren e punimeve që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohej që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në Detyren e Projektimit. Përcaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi detyren e projektimit dhe natyren e punimeve që do të realizohen, afateve për perfundimin e punimeve, si dhe mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikat “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8, të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënsi merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë,.....“. Kërkesa për disponimin e ekspertit të ndihmës së parë dhe ndërhyrjes në emergjencë gjatë proceseve të ndërtimit në kantier është i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentesh në vendin e punës, ul rrezikun e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësve, në rast aksidenti, në kantier. Në këto kushte, është kusht ligjor vendosja e këtij kriteri pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-në Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në

kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas certifikimit përkatës shmanq dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkcioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Njësi	Sasi	Statusi
1.	Total Station	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
2.	GPS/GNSS RTK	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
3.	Nivel laser	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
4.	Skaner armature / Rebar locator	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
5.	Sklerometër betoni	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
6.	Matës lagështie	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
7.	Printer/Plotter A3/A1	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
8.	Kontenierë për puntorë	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
9.	Kontenierë zyre kantieri	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
10.	Kontenierë zyre mbikqyesi	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
11.	Kontenierë magazinimi	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
12.	Profile metalike dhe panele sanduic /rrethimi kantieri sipas VKM	m2	540	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
13.	Skela metalike e certifikuar	m2	1600	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
14.	Prozhektor ndriçim kantieri	cope	4	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
15.	Tabela sigurimi në punë	cope	20	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
16.	Rripa sigurimi	cope	20	Pronesi/Qera/Fature furnizimi

17.	Fikse zjarri	cope	6	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
18.	Kuti ndihme e shpejtë	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
19.	Pajisje për punë në lartësi	cope	6	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
20.	Kamion me vinç me kapacitet ngritëse deri 20t	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
21.	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 1.5 Ton	cope	4	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
22.	Makine transport mallrash me kapacitet mbajtes	cope	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
23.	Pirun teleskopik me krah mbi 16 m (mjet teknologjik)	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
24.	Autobetoniere vetngarkuese kantieri deri ne 3.5 m3 (mjet teknologjik)	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
25.	Aspirator industrial largim ineretesh/mbeturinash me tub Ø300 deri 22m	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
26.	Transpaletë / platformë	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
27.	Pajisje për prerje me lazer/plazem	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
28.	Pajisje saldimi /Saldatriçe 400A	cope	3	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
29.	Pajisje axhustimi	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
30.	Depozite uji 5000l	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
31.	Kompresor ajri	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
32.	Ngjeshes/Tokmak	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
33.	Armaturë Kallëperi betoni	m2	100	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
34.	Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri)	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
35.	Vibratorë betoni	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
36.	Paisje saldimi me elektrofuzion	cope	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
37.	Paisje speciale për prerje me elektroda karboni	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
38.	Karroca dore	cope	4	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
39.	Pompë Suvatimi	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
40.	Gjenerator portativ kantieri	cope	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
41.	Skela të lëvizshme për ambiente të brendshme (10-20 m2)	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
42.	Aspirator industrial pluhuri	cope	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
43.	Set azoti + rregullator për prova presioni	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
44.	Pajisje saldimi/ brazimi për bakër	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
45.	Gazogjen	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
46.	Pompë uji	cope	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
47.	Sharr betoni	copë	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
48.	Kompresor trefazor	copë	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
49.	Trapan betoni	copë	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
50.	Sharr muri	copë	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
51.	Matrapik i kombinuar	copë	2	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
52.	Pompë lyerje me boje	copë	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi
53.	Betoniere 350 lt	copë	1	Pronesi/Qera/Fature furnizimi

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese"*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë, e cila duhet të jetë e vlefshme minimumi për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të zbatimit të punimeve.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit (të deklaruara në organet tatimore) ose fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë dhe duhet të jetë e vlefshme minimumi për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të zbatimit të punimeve

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të tjera të shpallura fitues.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar

Argumentimi: Ne bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me ane 17 të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë fuqine minimale punetore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, AK është bazuar në Detyrën e Projektimit si dhe në kontrata me objekt prokurimi të ngjashëm.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

SSH EN ISO 9001:2015	Menaxhimit të Cilësisë
SSH EN ISO 14001:2015	Menaxhimit Mjedisor
SSH EN ISO 45001:2023	Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
SSH EN ISO 50001:2018	Menaxhim të Energjisë
SSH EN ISO/IEC 3834-2:2021	Menaxhim të proceseve të saldimit të materialeve metalike.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rast bashkimi operatorësh mjafton që njëri nga O.E të plotësoj këtë kusht.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me ane 17 të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë fuqinë minimale punetore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbyshur kontratën.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues do të paraqesë në mënyrë të detajuar plan organizimin e punimeve në zbatim të ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për Sigurinë në kantiere"

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per

miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane 17 te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane ekspertizen, fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

2.4.4 Operatori ekonomik ofertues do te paraqese ne menyre te detajuar metodologjine e hartimit te prjoektit dhe zbatimit te punimeve objekt kontrate.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane 17 te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane ekspertizen, fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Projekt preventivi, projekti zbatimit, specifikimet teknike do të hartohen nga kontraktori në përputhje me detyrën e projektimit dhe do të miratohen nga Autoriteti Kontraktor pas nënshkrimit të kontratës

Komisioni unanimisht bëri miratimin e këtyre kriterëve për kualifikim dhe vendosi vazhdimin e mëtejshëm i procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)